

Për:	N.P. "KONAKU" me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	13.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 11.08.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.P. "KONAKU" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE CIVILËVE – LOT I**, me Numër të prokurimit: 623-20-3325-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-028-5-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.P. "KONAKU" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE CIVILËVE – LOT I**, me Numër të prokurimit: 623-20-3325-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-028-5-2-1, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: 07.08.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE CIVILËVE – LOT I**, me Numër të prokurimit: 623-20-3325-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-028-5-2-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: N.P. "KONAKU" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE CIVILËVE – LOT I**, me Numër të prokurimit: 623-20-3325-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-028-5-2-1, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: 07.08.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 11.08.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 1.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me Nenin 7, paragrafi 1 të LPP-së se *"Autoriteti Kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*,

Po ashtu pretendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me Nenin 59, të LPP-së, pasi që referencat tona tejkalojnë vlerën e kërkuar në Dosje të tenderit te cilat nuk janë marrë për bazë në rastin e vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertës, andaj kjo është shkelje e nenit 59 të LPP-së, paragrafi 4: *"Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*.

Pretendimet ankimor se Operatori Ekonomik i ka plotësuar Kërkesën 3. e kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se

Lot I – 245,000.00 €

Lot II – 48,000.00 €

- Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për Një (1) apo me shume pjesë (lot), shuma totale e kontratave të natyrës së ngjashme, qe kërkohet për Lotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.

- Shembull: Nëse shuma totale e kontratave të natyrës së ngjashme, e kërkuar për Lot I është: 245,000.00 € dhe për Lot 2 është: 48,000.00 €, atëherë kërkesa e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga O.E. është: 245,000.00 euro.

Dëshmia 3: Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Punët e kryera, shumën e kontratës, vendit dhe nr. e prokurimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellur me Kopje të Referencës ose Pranimet teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme.

Ju sqarojmë se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë, ju si Operatorë Ekonomik, nuk e keni plotësuar këtë kërkesë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, Referencat ose Pranimet teknike të dorëzuar në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, janë në vlerë prej: **70,867.50 Euro**, ku dhe me datë: 07.08.2020, me formular: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuari, jeni njoftuar nga Autoriteti Kontraktues duke cekur: *Referencës ose Pranimet teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, të dorëzuar nga ana juaj për Lot I janë në vlerë prej: 70,867.50 €, ndërsa në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e tenderit janë kërkuar në vlerë jo më pak se: Lot I 245,000.00 €, ju mungojnë referenca për punët e kryerja gjatë tre viteve të fundit në lëmin e punëve të ngjashme – Nuk e keni plotësuar këto*

Në bazë të Kërkesës tuaj për rishqyrtim, ku pretendoni se e plotëson kërkesën nr. 3 e kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, duke cekur se vlera e punëve të ngjashme nga ana juaj është në vlerë prej: 371,312.77 €.

Ky pretendim i juaj është i pa bazuar duke argumentuar se:

1. Rregullimi i rrethojës së oborrit dhe fushave sportive në shkollë, nuk ka të bëjë me natyrën e projektit të natyrës së punëve të ngjashme (pasi që të përshkruan i çmimeve nuk ka pjesë dominuese të rrethojës),
2. Ndërtimi i depove për lëndë djegëse në shkollë, sipas ligjit të ndërtimit, ndahet në projekte të ndërtimit të lartë dhe nuk ka të bëjë me natyrën e projektit të natyrës së punëve të ngjashme,
3. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatrat Terstenik I dhe Terstenik II, nuk ka të bëjë me natyrën e projektit të natyrës së punëve të ngjashme,
4. Rrethojat e fushave sportive për shkollë, nuk ka të bëjë me natyrën e projektit të natyrës së punëve të ngjashme,
5. Rrethoja e fushave sportive për shkollë – Faza e II, nuk ka të bëjë me natyrën e projektit të natyrës së punëve të ngjashme,
6. Renovimi i shkollës “Katër Dëshmorët” Krojmir, po ashtu edhe ky projekt nuk ka të bëjë me natyrën e projektit të natyrës së punëve të ngjashme.

Kurse sa i përket pretendimit tjetër duke cekur se: *OE të cilin e keni rekomanduar që të shpërblehet me kontratë N.P.T. “Bamirs” – Suharekë, referenca për punë të njëjta i ka në vlerë prej: 165,843.85 €, i cili nuk e plotëson kriterin sipas pretendimeve tuaja.*

Ky rekomandim i juaj është i pabazuar, pasi që përpos referencave të natyrës së ngjashme të cekura nga ana juaj janë në vlerë prej: 165,843.85 €, kemi dhe projektin të natyrës së ngjashme që është: Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit, ku vlera e kontratës është: 215,995.00 € dhe aneksi kontratë në vlerë prej: 21,565.00 €.

Dhe sipas argumenteve të lartë cekura OE i rekomanduar për kontratë e plotëson këtë kriter.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 2.

Lidhur me pretendimin ankimor duke cekur se: *Lista e stafit nuk është në harmoni me Listën e prezantuar në ATK për vitin 2020, janë deklaruar vetëm 7 nga gjithsej 10 që janë kërkuar.*

Pretendimet ankimor se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk i ka plotësuar Kërkesën 1. e kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, moshë e punëtorit, profesioni, eksperiencë (vite) dhe pozicioni në kompani.

Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, moshë e punëtorit, profesioni, eksperiencë (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëlosur nga Operatori Ekonomik.

Duke u bazuar në kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, e Operatori Ekonomik fitues e ka plotësuar këtë kërkesë, pasi që lista e punëtorëve të angazhuar për kryerjen e punëve, nuk është kërkuar nga ATK-ja, por sipas FDT – së është kërkuar: **Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri,**

mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.

Ku në ofertën e OE te rekomanduar për kontratë janë prezantuar me tabelare gjithsej: 16 Punëtor.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit